



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	16.06.2026	22.06.2026	2026/0377

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.06.2026, OE “HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0377, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ri-adaptimet e hapësirave në ndertesat qeveritare” me nr. të prokurimit: "214-25-3033-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë-punë vlera e parashikuar e kontratës: 750,000.00€. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr.0895-0904/2025, të datës 09.12.2025, dhe Vendim Nr. 0126/2026 të datës 20.04.2026. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 42 Publikimi i njoftimeve

Neni 43 Forma dhe Përmbajtja e Njoftimeve

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Neni 130 Shkeljet e Ligjit dhe Ndëshkimet

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 97 Shkeljet e rënda

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në kuadër të procedurës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare”, me numër të prokurimit 214-25-3033-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 26.05.2026 kemi pranuar njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit (B10). Si palë me interes në këtë procedurë shprehim mospajtimin tonë në lidhje me mosveprimet dhe veprimet e kundërligjshme të ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues në lidhje me anulimin e procedurës.

Përshkrimi i përgjithshëm:

Me dt.10.02.2026 Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme pas procesit të rivlerësimit ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku jemi rekomanduar për kontratë ne OE NNP “Hexagon Construction” Sh.p.k..

Lënda pastaj i është nënshtruar procesit të ankimimit në OSHP dhe me datë 20.04.2026, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka nxjerrë vendimin me nr. 2026/0126 duke e lënë në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme. Edhe pas vendimit të nxjerrë nga OSHP, Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë veprime të duhura dhe në pajtim me dispozitat ligjore, duke e vonuar procesin dhe duke nxjerrë vendime në kundërshtim me vendimin e OSHP, duke anuluar procedurën pa bazë ligjore.

Autoriteti Kontraktues me dt. 26.05.2026 ka publikuar njoftimin për Anulimin e procedurës së prokurimit (B10), Njoftim i cili është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së. Arsyeimi i dhënë nga AK për anulimin e procedurës bie në kundërshtim me nenin 62 të LPP.

Ne si kompani e dëmtuar nga ky vendim i AK-së kemi analizuar dhe i kemi paraqitur faktet dhe argumentet ligjore për shkeljet e bëra nga

AK gjatë kësaj procedure. Për të kërkuar të drejtën tonë legjitime paraqesim ANKESE për anulim të aktivitetit të prokurimit nga AK.

AK në kundërshtim me nenin Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, paragrafi 6, nuk ka kthyer fare pergjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij nen. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Andaj, pasi kanë kaluar të gjitha afatet ligjore dhe AK nuk ka respektuar nenin 108A të LPP-së, ne paraqesim ankesë në OSHP me këto pretendime ankimore:

Pika Ankimore 1 – Autoriteti Kontraktues, pas Vendimit të OSHP-së të datës 20.04.2026, nr. 2026/0126, i cili Vendim e ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58), në mënyrë që të zbatojë Vendimin e OSHP-së, është dashur që brenda 10 ditësh të na ftojë për të nënshkruar Kontratën. Quditërisht AK nuk ka zbatuar Vendimin e OSHP-së dhe për më tepër, ka marr një Vendim të RI, duke anuluar procedurën e prokurimit. Edhe me këtë Vendim për Anulim, AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore që parashihen me LPP. Pa një VENDIM të Autoritetit Kontraktues (B58), në të cilin Vendim do të na jepej rast të bëjmë kërkesë për rishqyrtim, ka bërë ANULIMIN DIREKT të procedurës duke përdorur formularin B10 (NJOFTIMI PËR ANULIM TË PROCEDURËS). Pra përveq që anulimi është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, AK po ashtu ka bërë shkelje procedurale, pa respektuar rregullat për Njoftim Vendim të AK. Sipas nenit 21 të Rregullorës për Prokurim Publik, AK nuk mundë të bëjë publikimin e Njoftimit për Anulim të Procedurës (B10), pa e bërë fillimisht publikimin e Njoftim Vendimit të AK përmes formës B58. Për këtë ne kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim me datë:29.05.2026, në të cilën kërkesë për rishqyrtim AK nuk është përgjigjur fare.

Pika Ankimore 2 – Vonesat e pajustificuara dhe mosveprimi i Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues, pas vendimit përfundimtar të OSHP-së të datës 20.04.2026 (vendimi 2026/0126), nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për më shumë se 36 ditë kalendarike, duke tejkaluar afatet e arsyeshme dhe duke mos ofruar asnjë arsyetim të bazuar ligjor lidhur me mosveprimin dhe vonesat e shkaktuara.

Me këtë mosveprim, AK ka shkelur parimet themelore të efikasitetit, proporcionalitetit dhe trajtimit të drejtë në procedurat e prokurimit publik. Vonesat e pajustificuara kanë shkaktuar pasoja të konsiderueshme financiare dhe organizative për kompaninë tonë.

Mosveprimi i Autoritetit Kontraktues pas një vendimit të OSHP-së përbën shmangie të detyrimeve ligjore dhe administrim joefikas të procedurës së prokurimit, duke dëmtuar drejtpërdrejt interesat legjitime të operatorit ekonomik fitues.

Pika Ankimore 3 – Moszbatimi i vendimit përfundimtar të OSHP-së

Autoriteti Kontraktues, përkundër vendimit përfundimtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit me të cilin është lënë në fuqi B58 – Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpalljen e kompanisë sonë fituese, nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimin e procedurës së prokurimit.

Pas përfundimit të të gjitha procedurave ankimore dhe konfirmimit të vendimit të AK-së nga OSHP, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që pa vonesa të vazhdojë me procedurat administrative për finalizimin e procedurës dhe nënshkrimin e kontratës me operatorin ekonomik fitues. Në vend të kësaj, AK ka vepruar në kundërshtim me obligimet ligjore që rrjedhin nga vendimi i OSHP-së dhe dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik.

Moszbatimi i vendimit përfundimtar të OSHP-së, parimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik, duke e bërë praktikisht të pazbatueshëm vendimin e organit kompetent shqyrtues. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe Anulimi i Aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sipas nenit 97 pika h. dhe pika k. konsiderohet si shkelje e **rëndë e Ligjit për Prokurim Publik**.

Pika Ankimore 4 – Anulimi i kundërligjshëm i procedurës së prokurimit

Vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedurës së prokurimit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 43 të Rregullores për Prokurim Publik, të cilat përcaktojnë në mënyrë taksative rastet kur një procedurë e prokurimit mund të anulohet.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të dëshmojë ekzistimin e ndonjëres nga rrethanat ligjore që do të justifikonin anulimin e procedurës pas përfundimit të procedurave ankimore dhe pas vendimit përfundimtar të OSHP-së me të cilin është lënë në fuqi vendimi për shpalljen e operatorit ekonomik fitues.

Arsyetimet e dhëna nga AK lidhur me riorganizimin institucional, ndarjen e ministrisë dhe rkijimin e strukturave të reja institucionale nuk përbëjnë bazë ligjore për anulimin e procedurës, përkundrazi legjislacioni në fuqi, duke përfshirë: *Ligji nr.03 L/048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji nr.10 L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Ligji nr.06 L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe Rregullore (QRK) nr.04_2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive*, përcaktojnë qartë se në rastet e riorganizimit të institucioneve bëhet bartja e kompetencave dhe përgjegjësisë, si dhe përshtatjet e nevojshme të buxhetit dhe obligimeve të cilat realizohen tek institucioni pasues, pa ndërprerë obligimet administrative dhe kontraktuale ekzistuese.

Meqenëse buxheti i planifikuar tani për këtë projekt, sipas strukturës së re institucionale ka kaluar në MDAP, e njoftojmë Ministrinë se në ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2026, buxheti për këtë projekt është i planifikuar në kuadër të MPB, ndërsa sa i përket viteve në vazhdim, në pajtim me legjislacionin dhe procedurat administrative bëhet përshtatja dhe bartja e përgjegjësisë, njëjtë sikurse keni vepruar në rastet e kontratave tjera të cilat janë në realizim e sipër.

Ministria ka praktika që pas riorganizimit institucional ka bërë transferimin e kontratave

ekzistuese të cilat janë duke u realizuar, shtrohet pyetja çfarë veprime ka marrur Minsitria dhe si janë transferuar këto kontrata që tani janë duke u realizuar?!

Në bazë të legjislacionit duhet të ketë vazhdimësi institucionale në ofrimin e shërbimeve dhe bashkëpunim ndër institucional në adminsitratën shtetërore në pajtim me legjislacionin e sipërcekur në fuqi.

Ndërprerja e një procedurë prokurimi në fazën përfundimtare të saj edhe pas vendimit final të OSHP (obligim ligjor për AK që të zbatohet), vetëm se është riorganizuar institucioni është në kundërshtim të plotë me LPP-në. Asnjë dispozitë ligjore e LPP-së nuk parasheh që riorganizimi institucional të përbëjë bazë automatike për anulimin e një procedure të prokurimit.

Me nxjerrjen e vendimit për anulim në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka cenuar sigurinë juridike, ka shmangur zbatimin e vendimit përfundimtar të OSHP-së dhe ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimit Publik.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara në pikat ankimore, si dhe në dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, përfshirë nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të Rregullores për Prokurim Publik, konstatohet se vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedurës së prokurimit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe në kundërshtim me vendimin përfundimtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Kjo gjithashtu konform nenit 97 të LPP-së përbën shkelje të rëndë të legjislacionit.

Në këtë rast, pas përfundimit të të gjitha procedurave ankimore dhe vendimit të OSHP-së me të cilin është lënë në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpalljen e kompanisë sonë fituese, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të vazhdojë procedurën me nënshkrimin e kontratës dhe realizimin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në vend të zbatimit të këtij obligimi ligjor, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendim për anulimin e procedurës, pa bazë ligjore të justifikuar dhe pa u plotësuar kushtet e përcaktuara me ligj për anulimin e një procedure të prokurimit publik.

Pika Ankimore 5 – Mos nxjerrja e vendimit në kërkesën për rishqyrtim:

AK në kundërshtim me nenin Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, paragrafi 6, nuk ka kthyer fare pergjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Ne si OE, në mungesë të përgjigjes apo vendimit të AK mbrenda afatit kohor të përcaktuar me LPP dhe RRPP 001/2022, në përputhje me nenin 63 pika 2 parashtrijmë këtë ankesë.

Neni 63 Vendimi i Autoritetit Kontraktues

63.2. Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik si "Dokument shtesë" tek dosja e tenderit nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit. Në rastet kur zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejtë që të parashtroj një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

Demet financiare

Mosveprimi në kohë, vonesat e pajustificuara si dhe vendimi i kundërligjshëm për anulimin e procedurës nga ana e Ministrisë kanë shkaktuar dhe po vazhdojnë të shkaktojnë dëme të konsiderueshme financiare dhe operative për kompaninë tonë. Përveç dëmeve financiare të shkaktuara nga procesi i procedurës së prokurimit, kompania jonë ka angazhuar dhe ka mbajtur ne gjendje staf profesional dhe teknik për realizimin e kontratës, duke krijuar kosto të drejtpërdrejta për pagat dhe planifikimin e burimeve njerëzore.

Po ashtu, në pritje të nënshkrimit dhe realizimit të kontratës, kompania ka hequr dorë nga pjesëmarrja në procedura të tjera të prokurimit, duke humbur mundësi të tjera kontraktuale.

Në kuadër të përgatitjeve për ekzekutimin e projektit, janë bërë investime në pajisje, mjete pune dhe organizim operacional, të cilat aktualisht kanë mbetur të pashfrytëzuara dhe kanë krijuar ngarkesë financiare shtesë.

Gjithashtu, janë shkaktuar kosto administrative dhe organizative për planifikim, mobilizim dhe përgatitje të brendshme të kompanisë, të cilat janë realizuar vetëm për këtë kontratë dhe kanë mbetur pa efekt praktik për shkak të tejzgjatjes dhe mosveprimeve në kohë dhe vendimeve të kundërligjshme të ndermarra nga AK.

Si pasojë e kësaj gjendjeje, kompania jonë po përballet me dëme financiare edhe humbje të fitimit të pritur, si dhe me cenim të planifikimit të rregullt të veprimtarisë afariste dhe stabilitetit financiar.

Për këto arsye, kërkojmë nga OSHP që të aprovojë ANKESËN si të bazuar. Te detyrojë AK që të anulojë vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit si vendim i kundërligjshëm dhe i marrë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, nenin 43 të RRPP-së dhe vendimin e OSHP-së i cili ka lënë në fuqi Vendimin e AK, ku ne jemi rekomanduar për kontratë dhe të marr masat për zbatimin e Vendimit të

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare**” me numër të prokurimit: “**214-25-3033-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

KRITERET PËR VLERËSIM

--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

NJOFTIMI PËR ANULIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT

IV.1) Data e vendimit mbi anulimin e procedurës 26.05.2026

IV.2) Numri i tenderëve të pranuar 6

IV.3) Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik:

Pas hapjes së tenderëve

- ☐ Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit;
- ☒ Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;
- ☐ Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në mase substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;

Para hapjes së tenderëve

- ☐ Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Cdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shtu informacione tjera:

Pas inicimit të kësaj procedure, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 02 02 të datës 20.02.2026 për riorganizimin institucional, është bërë ndarja e ministrisë, ku si rezultat janë krijuar struktura të reja institucionale. Si pasojë e këtij riorganizimi institucional është bërë edhe ndarja e përgjegjësi dhe kompetencave përkatëse ndërmjet institucioneve të reja si dhe ndarja e buxhetit. Për shkak të këtij ndryshimi, Autoriteti Kontraktues-MPB nuk disponon mjetet e nevojshme buxhetore për realizimin e kësaj procedure të prokurimit, pasi buxheti i planifikuar për këtë aktivitet është ndarë sipas strukturës së re institucionale dhe ka kaluar në MDAP.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Më datë 19.06.2026 kamë kërkuar sqarime nga AK.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimin PSH.nr.0895-0904/2025, të datës 09.12.2025, dhe Vendim PSH.nr. 0126/2026 të datës 20.04.2026.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K.**

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë-punë. Vlera e parashikuar 750,000.00€. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**.

Sqarim hyrës: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, ku kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, ndërsa **ekspertja shqyrtuese** ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.0895/2025, dhe Nr.0904/2025, të datës 29.09.2025 dhe raport të ekspertizës me Nr.0126/2026 të datës 11.03.2026. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.0895-0904/2025, të datës 09.12.2025, dhe Vendim PSH.nr. 0126/2026 të datës 20.04.2026.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59,42,43,62,130, 108/A, të LPP-së, si dhe nenin 97 dhe Rregullores nr.001/2022 për prokurim publik. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe jep përgjigje si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues pretendon Autoriteti Kontraktues, pas Vendimit të OSHP-së të datës 20.04.2026, nr. 2026/0126, i cili Vendim e ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58), në mënyrë që të zbatojë Vendimin e OSHP-së,

është dashur që brenda 10 ditësh të na ftojë për të nënshkruar Kontratën. Çuditërisht AK nuk ka zbatuar Vendimin e OSHP-së dhe për më tepër, ka marr një Vendim të RI, duke Anuluar procedurën e prokurimit. Edhe me këtë Vendim për Anulim, AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore që parashihen me LPP. Pa një VENDIM të Autoritetit Kontraktues (B58), në të cilin Vendim do të na jepej rast të bëjmë kërkesë për rishqyrtim, ka bërë ANULIMIN DIREKT të procedurës duke përdorur formularin B10 (NJOFTIMI PËR ANULIM TË PROCEDURËS). Pra përveç që anulimi është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, AK po ashtu ka bërë shkelje procedurale, pa respektuar rregullat për Njoftim Vendim të AK. Sipas nenit 21 të Rregullores për Prokurim Publik, AK nuk mundë të bëjë publikimin e Njoftimit për Anulim të Procedurës (B10), pa e bërë fillimisht publikimin e Njoftim Vendimit të AK përmes formës B58. Për këtë ne kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim me datë:29.05.2026, në të cilën kërkesë për rishqyrtim AK nuk është përgjigjur fare.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues potencon se vonesat e pajustificuara dhe mosveprimi i Autoritetit Kontraktues, pas vendimit përfundimtar të OSHP-së të datës 20.04.2026 (vendimi 2026/0126), nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për më shumë se 36 ditë kalendarike, duke tejkaluar afatet e arsyeshme dhe duke mos ofruar asnjë arsyetim të bazuar ligjor lidhur me mosveprimin dhe vonesat e shkaktuara. Me këtë mosveprim, AK ka shkelur parimet themelore të efikasitetit, proporcionalitetit dhe trajtimit të drejtë në procedurat e prokurimit publik. Vonesat e pajustificuara kanë shkaktuar pasoja të konsiderueshme financiare dhe organizative për kompaninë tonë. Mosveprimi i Autoritetit Kontraktues pas një vendimit të OSHP-së përbën shmangie të detyrimeve ligjore dhe administrim joefikas të procedurës së prokurimit, duke dëmtuar drejtpërdrejt interesat legjitime të operatorit ekonomik fitues.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon se moszbatimi i vendimit përfundimtar të OSHP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues, përkundër vendimit përfundimtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit me të cilin është lënë në fuqi B58 – Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpalljen e kompanisë sonë fituese, nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimin e procedurës së prokurimit. Pas përfundimit të gjitha procedurave ankimore dhe konfirmimit të vendimit të AK-së nga OSHP, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që pa vonesa të vazhdojë me procedurat administrative për finalizimin e procedurës dhe nënshkrimin e kontratës me operatorin ekonomik fitues. Në vend të kësaj, AK ka vepruar në kundërshtim me obligimet ligjore që

rrjedhin nga vendimi i OSHP-së dhe dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik. Moszbatimi i vendimit përfundimtar të OSHP-së, parimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik, duke e bërë praktikisht të pazbatueshëm vendimin e organit kompetent shqyrtues. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe Anulimi i Aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sipas nenit 97 pika h. dhe pika k. konsiderohet si shkelje e rëndë e Ligjit për Prokurim Publik.

Pretendimi ankimor 4: OE ankues potencon se anulimi i kundërligjshëm i procedurës së prokurimit Vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedurës së prokurimit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 43 të Rregullores për Prokurim Publik, të cilat përcaktojnë në mënyrë taksative rastet kur një procedurë e prokurimit mund të anulohet. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të dëshmojë ekzistimin e ndonjëres nga rrethanat ligjore që do të justifikonin anulimin e procedurës pas përfundimit të procedurave ankimore dhe pas vendimit përfundimtar të OSHP-së me të cilin është lënë në fuqi vendimi për shpalljen e operatorit ekonomik fitues. Arsyetimet e dhëna nga AK lidhur me riorganizimin institucional, ndarjen e ministrisë dhe rikrijimin e strukturave të reja institucionale nuk përbëjnë bazë ligjore për anulimin e procedurës, përkundrazi legjislacioni në fuqi, duke përfshirë: Ligji_nr.03 L/048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji_nr.10 L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Ligji_nr.06 L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe Rregullore (QRK) nr.04_2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, përcaktojnë qartë se në rastet e riorganizimit të institucioneve bëhet bartja e kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe përshtatjet e nevojshme të buxhetit dhe obligimeve të cilat realizohen tek institucioni pasues, pa ndërprerë obligimet administrative dhe kontraktuale ekzistuese. Meqenëse buxheti i planifikuar tani për këtë projekt, sipas strukturës së re institucionale ka kaluar në MDAP, e njoftojmë Ministrinë se në ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2026, buxheti për këtë projekt është i planifikuar në kuadër të MPB, ndërsa sa i përket viteve në vazhdim, në pajtim me legjislacionin dhe procedurat administrative bëhet përshtatja dhe bartja e përgjegjësi, njëjtë sikurse keni vepruar në rastet e kontratave tjera të cilat janë në realizim e sipër.

Ministria ka praktika që pas riorganizimit institucional ka bërë transferimin e kontratave ekzistuese të cilat janë duke u realizuar, shtrohet pyetja çfarë veprime ka marrë Ministria dhe

si janë transferuar këto kontrata që tani janë duke u realizuar?!

Në bazë të legjislacionit duhet të ketë vazhdimësi institucionale në ofrimin e shërbimeve dhe bashkëpunim ndër institucional në administratën shtetërore në pajtim me legjislacionin e sipër cekur në fuqi. Ndërprerja e një procedurë prokurimi në fazën përfundimtare të saj edhe pas vendimit final të OSHP (obligim ligjor për AK që të zbatohet), vetëm se është riorganizuar institucioni është në kundërshtim të plotë me LPP-në. Asnjë dispozitë ligjore e LPP-së nuk parasheh që riorganizimi institucional të përbëjë bazë automatike për anulimin e një procedure të prokurimit. Me nxjerrjen e vendimit për anulim në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka cenuar sigurinë juridike, ka shmangur zbatimin e vendimit përfundimtar të OSHP-së dhe ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimit Publik. Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara në pikat ankimore, si dhe në dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, përfshirë nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të Rregullores për Prokurim Publik, konstatohet se vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedurës së prokurimit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe në kundërshtim me vendimin përfundimtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Kjo gjithashtu konform nenit 97 të LPP-së përbën shkelje të rëndë të legjislacionit. Në këtë rast, pas përfundimit të të gjitha procedurave ankimore dhe vendimit të OSHP-së me të cilin është lënë në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpalljen e kompanisë sonë fituese, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të vazhdojë procedurën me nënshkrimin e kontratës dhe realizimin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në vend të zbatimit të këtij obligimi ligjor, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendim për anulimin e procedurës, pa bazë ligjore të justifikuar dhe pa u plotësuar kushtet e përcaktuara me ligj për anulimin e një procedure të prokurimit publik.

Pretendimi ankimor 5: OE ankues potencon se mos nxjerrja e vendimit në kërkesën për rishqyrtim: AK në kundërshtim me nenin Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, paragrafi 6, nuk ka kthyer fare përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve 6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë. Ne si OE, në mungesë të përgjigjes apo vendimit të AK brenda afatit kohor të përcaktuar me LPP dhe

RRPP 001/2022, në përputhje me nenin 63 pika 2 parashtrojmë këtë ankesë. Neni 63 Vendimi i Autoritetit Kontraktues. 63.2. Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik si “Dokument shtesë” tek dosja e tenderit nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit. Në rastet kur zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtoj një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

Përgjigje në pretendimet ankimore: Meqenëse pretendimet ankimore janë pothuajse të njëjta për nga përmbajtja por pretendimet në shkelje ligjore të ndryshme, **ekspertja shqyrtuese** në vijim do të jep përgjigje të përmbledhur në pikat ankimore.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se me datën 26.05.2026, AK ka publikuar njoftimin B10 për anulimin e aktivitet të prokurimit, me arsyetimin:

Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Dhe me informacione shtesë si vijon:

“Pas inicimit të kësaj procedure me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 02/02 të datës 20.02.2026 për riorganizimin institucional është bere ndarja e ministrisë ku si rezultat janë krijuar struktura të reja institucionale. Si pasoj e këtij riorganizimi institucional është bere edhe ndarja e përgjegjësive dhe kompetencave përkatës ndërmjet institucioneve te reja si dhe ndarja e buxhetit. Për shkak te këtij ndryshimi Autoriteti kontraktues –MPB nuk disponon mjetet e nevojshme buxhetore për realizimin e kësaj procedure të prokurimit , pasi buxhetit i planifikuar për këtë aktivitet është ndarë sipas strukturës se re institucionale dhe ka kaluar më MDAP”.

Duke u bazuar në pretendimet e OE ankues si dhe arsyetimin e AK-s? mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vendimin Nr.02/02 të datës 20.02.2026 për riorganizimin institucional, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se përmes emailit zyrtar i jemi drejtuar AK-së me

kërkesë për sqarime shtesë, ku AK përmes emailit kanë kthyer përgjigje dhe kanë bashkangjitur komunikimin zyrtar duke informuar se pas ndarjes së MPB-së nga MAP tani MDAP, buxheti për “Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare” më nuk është në MPB dhe ky buxhet ka kaluar te MDAP-ja në programin DSPIMNQ-së për projektin “Renovimi i Projekteve Qeveritare-12992”. Lidhur me këto ndryshime në ndarje të ministrive, në vijim bashkëngjisim komunikimet e zyrtarëve të MPB-së:

From: Drita Xheladini
Sent: 18 May 2026 15:33
To: Agim Islami
Cc: Genc Metaj; Flurije Durmishi; Adifete N.Qerimi; Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në MPB
Subject: RE: Kërkesë per Informata
Attachments: B04 Deklarata e Nevojave dhe Percaktimit te Disponueshmerise se fondevepdf

I nderuar,

Për njoftimin tuaj siç e keni cekur edhe ju se pas ndarjes së MPB-se nga ish-MAP tani MDAP, buxheti për “Ri-adaptimet e hapësirave në Ndërtesat Qeveritare” nuk është në MPB, ky buxhet ka kaluar te MDAP-ja pikërisht te programi i DSPIMNQ-se te projekti Renovim i Projekteve Qeveritare-12992 siç edhe ka qenë i planifikuar.

Me respekt!

Drita Xheladini-Drejtoreshë e Departamentit për Buxhet dhe Financa/ZKF
Ministria e Punëve të Brendshme
Tel. 038/ 521-136 ; 200 19-655
E-mail: drita.xheladini@ks-gov.net

From: Agim Islami
Sent: 15 May 2026 15:14
To: Drita Xheladini <Drita.Xheladini@rks-gov.net>
Cc: Genc Metaj <Genc.Metaj@rks-gov.net>
Subject: RE: Kërkesë per Informata

Te bashkangjitur Disponushmerin e mjeteve

Me respekt

From: Agim Islami
Sent: 15 May 2026 15:11
To: Drita Xheladini <Drita.Xheladini@rks-gov.net>
Cc: Genc Metaj <Genc.Metaj@rks-gov.net>
Subject: Kërkesë për Informata

E nderuar

Ne lidhje me një aktivitet të prokurimit të vitit 2025 për “Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare” me nr. të prokurimit 214-25-3033-5-1-1, ju informojmë se për shkak të paraqitjes së ankesave ky aktiviteti i

1

prokurimit ka qene deri tash ne OSHP, sipas vendimi të OSHP, ankesat janë refuzuar dhe vendimi i AK-MPB ka mbetur ne fuqi.

Meqenëse ky aktivitet është iniciuar me datën 05.05.2025 dhe konfirmimi i mjeteve për herën e dytë është bere me 27.08.2025 dhe marre parasysh edhe vendimin e Qeverise për ndarje të ministrive, ju lutem të na informoni se a kemi mjete buxhetore për aktivitetin në fjalë, në mënyrë që ne të ecim me procedurë të publikimit të dhënies së kontratës.

Me respekt
Agim Islami
UD. i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit
Ministria e Punëve të Brendshme
Republika e Kosovës, 10000 - Prishtinë
Tel: 038 200 76 632
email: Agim.Islami@rks-gov.net

Pas shqyrtimit të këtij komunikimi në lidhje me ndarjen e MPB-së dhe ndryshimeve të bëra nga qeveria në MPB, **ekspertja shqyrtuese** konsideron se me dispozitat ligjore të LPP-së nuk ka asnjë mundësi ligjore që të bëhet anulimi i procedurës tani në këtë fazë. Këtë vlerësim **ekspertja shqyrtuese** e bazon në nenin 8 (Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve), par. 8.1, 8.2 dhe 8.5 të Rregullores. Kjo dispozitë ligjore e obligon autoritetin kontraktues që të sigurohet se fondet janë alokuar, që në rastin konkret fondet ishin alokuar, pastaj obligon AK që të përdor formularin standard B04 “Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve (DNPDF)” që në rastin konkret edhe ky formular ishte plotësuar duhet vërtetuar se fondet janë alokuar, si dhe par. 8.5 i nenit 8 të Rregullores obligon personat përgjegjës që para publikimit të formularit B58 “Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar, ku AK kishte rikonfirmuar që fondet janë të alokuara dhe ka bërë publikimin e formularit B58 duke e shpallur fitues tani OE ankues. Pra, para shpalljes së fituesit (publikimit

të vendimit B58), AK ka ndërmarr të gjitha veprimet duke u siguruar që ka fonde të mjaftueshme për të vazhduar me nënshkrimin e kontratës. Përveç kësaj, ekziston edhe vendimi Nr.2026/0126 i nxjerr nga OSHP, me të cilin vërtetohet vendimi i AK-së. Andaj, duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe fazën në të cilën është anuluar, është e pamundur ligjërisht që të anulohet kjo procedurë.

Sa i përket pikës ankimore që ka të bëjë me shkeljet procedurale gjatë këtij aktiviteti të prokurimi, konkretisht mos respektimi i nenit 21 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, mos trajtimi i kërkesës për rishqyrtim, dhe mos respektimi i vendimit të OSHP-së të datës 20.04.2026 nr. 2026/0126, **ekspertja shqyrtuese** vlerëson se AK nuk ka zbatuar nenin 21 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik konkretisht në pikën “f”, ku thuhet:

f. Autoriteti Kontraktues duhet të publikoj Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58) edhe në rast se vendimi ka të bëjë me anulimin e aktivitetit të prokurimit në tërësi ose një/disë Lot e në kuadër të aktivitetit të prokurimit.

Po ashtu nuk ka vepruar sipas 108/A të LPP-së, pasi nuk ka trajtuar kërkesën për ri shqyrtim dhe asnjë prej detyrimeve të AK-së që janë përcaktuar në këtë dispozitë ligjore nuk është përfillur nga AK. Ky vlerësim bazohet në dispozitën ligjore të cekur më lart, ku fillimisht obligohet AK që me rastin e trajtimit të kërkesës për ri shqyrtim të parashtruar nga OE, të nxjerr vendim dhe të kthen përgjigje në secilën pikë ankimore. Andaj, pretendimi ankimor i OE është i bazuar.

Në mbështetje të asaj që u tha më lartë, ekspertja shqyrtuese konsideron se ankesa e OE ankues është e bazuar, kurse vendimi i AK-së për anulimin e procedurës është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43.5 të Rregullores për Prokurim Publik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare**” me numër të prokurimit: “**214-25-3033-S-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K.**

Majlinda Bedrolli

